

Në bazë të nenit 23 paragrafi 4 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/05 dhe 103/08, dhe në lidhje me nenin 7 dhe nenin 19 paragrafi (2) të Rregullores për masat teknike dhe organizative për sigurimin e fshehtësisë dhe mbrojtjes së përpunimit të të dhënave personale 02-4283/1 1307 2018, Ministri i Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës miratoi:

UDHËZUES

PËR MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË EVIDENCËS PËR PERSONAT E AUTORIZUAR PËR KRYERJEN E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE NË MINISTRINË E SHOQËRISË INFORMATIKE DHE ADMINISTRATËS

Neni 1

Me këtë udhëzim përshkruhet mënyra e administrimit të evidencës për personat e autorizuar për kryerjen e përpunimit të të dhënave personale në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Neni 2

Personat e autorizuar për kryerjen e përpunimit të të dhënave personale në Ministrinë e Shoqërisë Informatike në kuptim të këtij udhëzuesi janë personat e punësuar ose të angazhuar në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës të cilat kanë qasje tek dokumentet të cilat përmbajnë të dhëna personale dhe deri te pajisjet e komunikimit informatik.

Neni 3

Për përpunimin e të dhënave personale në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, ministri sjell aktvendim.

Neni 4

Për vendimet e dhëna nga neni 3 i këtij udhëzuesi, në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës administrohet evidenca e cila i përmban të dhënat në vijim:

1. Numrin rendor
2. Emrin, mbiemrin dhe vendin e punës të personit të autorizuar
3. Lloji i autorizimit

4. Numri dhe data e aktvendimit
5. Vërejtje

Evidencën nga paragrafi 1 i këtij neni e administron zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Evidenca nga paragrafi 1 i këtij neni administrohet në formularin nr. 1, i cili është pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi.

Neni 5

Ky udhëzues hyn në fuqi me ditën e sjelljes së tij.